

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7810
E mërkurë, 12 qershor 2024
Çmimi 0.50 €

Limaj në Parlamentin e Shqipërisë, nderohet për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



HOVENIER: DIALOGU DUHET TË PËRFUNDOJË ME NJOHJE

FAQE 4-5



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se përkushtimi i ShBA-ve ndaj Kosovës dhe rajonit është i fortë dhe i qëndrueshëm. Në samitin

"The Western Balkans 2024", që po mbahet në Prishtinë, Hovenier theksoi edhe rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve që Kosova dhe Serbia kanë arritur në kuadër të

dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Sipas tij, dialogu mes Kosovës dhe Serbisë është një sfidë që duhet tejkaluar vetëm me njohje reciproke dhe jo diçka më pak

AKTUALE



GJYKATA E AELIT I JEP VULËN E PD-SË BERISHËS, RRËZOHET LULZIM BASHA | F. 2

PE-JA DO TA VAZHDOJË MBËSHETJEN PËR ZGJERIMIN, RREZIKU QËNDRON TE DISA VENDE ANËTARE | F. 3

POLICËT E KOSOVËS TRAJNOHEN NGA INSTRUKTORË TË DEA-SË | F. 3

EKONOMI



KURTI TAKOHET ME PËRFAQËSUES TË GRUPIT TË INOVACIONIT "YES-EU", FLASIN PËR INVESTIME NË ENERGI | F. 8

"TREPÇA" KËRKON KTHIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME, JEP AFAT 30 DITË | F. 8

SPORT



'DARDANET' U17 MBAJTËN GRUMBULLIM TREDITOR | F. 10

RRETH 200 ANKESA TË QYTETARËVE NDAJ GJYQATARËVE E PROKURORËVE GJATË VITIT 2023 | F. 7



KURTI DHE ROBERTSON MARRIN PJESË NË HAPJEN E EKSPOZITËS FOTODOKUMENTARI 'KFOR AND KOSOVO + 25' | F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjykata e Apelit i jep vulën e PD-së Berishës, rrëzohet Lulzim Basha

TIRANË, 11 QERSHOR - Vendimi i Kuvendit të jashtëzakonshëm të Partisë Demokratike që më 11 dhjetor 2021 shkarkoi si kryetar Lulzim Basha u la në fuqi nga Gjykata e Apelit. Këtë të martë tre gjyqtaret Alma Ahmeti, Elona Toro dhe Iliba Bezati vendosën unanimitisht të mos pranojnë ankimimin e Enkelejd Alibeajt, pjesë e grupimit Basha, për të zhbërë vendimin e dy viteve më parë të Gjykatës së Shkallës së Parë, që njohu legjitimitetin e Kuvendit të Rithemelimit të Partisë Demokratike. Vendimi i Gjykatës së Apelit do të thotë se kryetar i

PD-së, edhe zyrtarisht tani është Sali Berisha. Me këtë verdikt zgjidhet çdo mosmarrëveshje mbi vulën, logon, simbolet dhe forumet politike të Partisë Demokratike. Sali Berisha është i fituari i madh i kësaj beteje ligjore.

Por a mbyllet këtu kjo çështje? E sigurt është që ky vendim i Apelit është i formës së prerë.

Po ashtu e sigurt është që humbësit mund të bëjnë rekurs në gjykatën e lartë. E njëherazi e sigurt është që nëse ndodh diçka e tillë, mediat do ta ndjekin me të njëjtin interes.

Megjithatë, edhe nëse pala e

Bashës e ankimon vendimin në gjykatën e Lartë, me zbardhjen e vendimit, gjithçka kalon në duart e Sali Berishës dhe forumeve të dala nga Kuvendi i 11 dhjetorit.

Në mënyrë të përsëritur Lulzim Basha pati deklaruar se do ta njohë vendimin e gjykatës dhe ftoi palën tjetër të bëjë të njëjtën gjë. Por tani që humbi me vendim të formës së prerë pritet të shikohet a do të ankohet apo jo për vulën. Pala tjetër që është fitimtarja i ka vendimet më të thjeshta. Mesazhi i parë më i rëndësishëm është ai i bashkimit.



ShBA-ja dhe Polonia bashkojnë forcat kundër dezinformimit rus në Ukrainë

WASHINGTON, 11 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara dhe Polonia krijuan një grup për të ndihmuar Ukrainën në luftimin e dezinformimit rus, njoftoi Qendra Globale e Angazhimit e Departamentit amerikan të Shtetit.

Qendra Globale e Angazhimit, e cila punon për të nxjerrë në pah dezinformatat nga ato që i konsideron shtete armiqësore, tha se Grupi i përbashkët i Komunikimit për Ukrainën, ose UCG, u formua në Varshavë.

Qëllim i tij është t'i jepet mbështetje Ukrainës "në luftën



kundër agresionit të Rusisë në hapësirën e informacionit". Departamenti amerikan i Shtetit

tha se grupi i ri do t'i bashkojë aleatët "për të koordinuar mesazhet, për të promovuar

raportimin e saktë rreth pushtimit rus të Ukrainës, për të përforcuar zërat ukrainas dhe për të ekspozuar manipulimin e informacioneve nga Kremli".

Departamenti i Shtetit tha, po ashtu, se Kremli "përdor gënjeshtër dhe manipulime në mënyrë të përsëritur, për të nxjerrë pretekste të rreme për pushtimin e pajustificueshëm", si dhe "për të bërë përpjekje për të prishur solidaritetin mbarëbotëror me popullin ukrainas".

Kremli i mohoi pretendimet se

përhap dezinformata dhe akuzoi Perëndimin për përfshirje në "terrorizëm informacioni".

Sipas agjencisë së lajmeve Associated Press, zyrtarët polakë thonë se Polonia është bërë, gjithashtu, objektivi i sabotazhit dhe masave të tjera përçarëse nga shërbimet sekrete ruse.

Polonia, anëtare e NATO-s, është strehë për një numër të konsiderueshëm refugjatësh ukrainas, të cilët ikën nga vendi i tyre prej se Rusia nisi pushtimin e tij në shkallë të plotë, në shkurt të vitit 2022.

Kryeministrja daneze paralajmëron për rritje të agresionit, pas sulmit ndaj saj



KOPENHAGË, 11 QERSHOR - Kryeministrja e Danimarkës, Mette Frederiksen, tha të martën se ende është duke e marrë veten fizikisht dhe mendërisht nga sulmi kundër saj në qendër të Kopenhagës javën e kaluar, si dhe paralajmëroi për rritje të veprimeve të dhunshme në publik.

Një burrë polak, 39 vjeç, është futur në paraburgim si i dyshuar për sulmin ndaj Frederiksenit, si rrjedhojë e të cilit ajo pësoi

lëndime në qafë. Sulmuesi ishte nën ndikimin e alkoolit dhe drogës në atë kohë, prandaj nuk ka ndonjë tregues për motive politike, thanë autoritetet. "Ende nuk jam vetja. Unë kujdesem për punën time si kryeministre dhe gjithmonë do ta bëj. Isha në gjendje të punoja edhe në fundjavë, por jo në mënyrë të zakonshme", tha Frederiksen në një intervistë për transmetuesin DR. Sulmi ndaj saj ndodhi vetëm tri

javë pasi kryeministri i Sllovakisë, Robert Fico, u plagos rëndë në një tentim-vrasje.

Frederiksen tha se ka qenë dëshmitare e një ndryshimi në sferën publike në vitet e fundit. "Ka pasur kërcënime për një kohë të gjatë, tone të vrazhda në rrjetet sociale, të cilat janë përkeqësuar, posaçërisht pas luftës në Lindjen e Mesme. Shumë britma në publik, ku njerëzit sillen në mënyrë shumë, shumë agresive", tha ajo. Danimarka renditet si njëra prej

vendeve më të lumtura në botë, ku danezët krenohen me barazinë, gjithëpërfshirjen dhe modelin e mirëqenies së bollshme. "Ne jemi krenar për vendin ku kryeministrja shkon në punë me biçikletë", shtoi ajo. "Por, një ndryshim ka ndodhur. Unë gjithmonë kam qenë në dispozicion, por skena në rrugë ka ndryshuar, sepse ka vende ku ne nuk mund të shkojmë më, së paku disa prej neve politikanëve", theksoi ajo.

Zyra e Ambasadës ruse hapet në Banja Llukë

Banja Llukë, 11 qershor - Marrëdhëniet tona me Republikën Serpska po përjetojnë një rritje të madhe, tha ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov. "Kontaktet në nivelin më të lartë janë bërë të rregullta", sipas tij. Lavrov i bëri komentet gjatë një video-adresimi me rastin e

hapjes së Zyrës së Ambasadës ruse në Banja Llukë, të martën. Me këtë veprim, Bosnje e Hercegovina u bë vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, ku Rusisë iu mundësua zgjerimi i misionit diplomatik, pasi nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, në vitin 2022. Lavrov tha se ky është një

moment "historik" dhe se "ne kemi punuar për këtë qëllim tash e disa vite". "Ne do t'i kushtojmë vëmendje prioritare ndërtimit të tempullit rusoserb, si një qendër shpirtërore dhe kulturore në Banja Llukë", tha po ashtu Lavrov. Zyrën e hapën Millorad Dodik, president i entitetit serb të

Bosnjës, Republika Serpska, dhe Igor Kalabuhov, ambasador i Rusisë në Bosnje e Hercegovinë.

Për hapjen e saj ishte rënë dakord në vitin 2021, para fillimit të pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Për mundësinë që konsullata të hapet këtë vit, Dodik



paralajmëroi qysh në shkurt. Atë e konfirmoi pastaj edhe përfaqësia e Republikës Serpska në Moskë.

Policët e Kosovës trajnohen nga instruktorë të DEA-së

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Policia e Kosovës në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Programin Ndërkombëtar të Asistencës në Trajnim për Hetimet Kriminale të Departamentit të Drejtësisë (ICITAP) dhe Administratën për Zbatimin e Drogës (DEA), përfunduan me sukses kursin e avancuar njëjavor për operacione të fshehta të mbajtur në Prishtinë.

Të 22 pjesëmarrësve, përfaqësues të Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit

Policor, iu dorëzuan certifikatat. Kursi i zhvilluar nga instruktorë të DEA-s, u vlerësua për përmbajtjen e tij të specializuar, të avancuar dhe informative, i cili u dha pjesëmarrësve njohuri të vlefshme për zhvillim profesional.

Në ceremoninë e diplomimit morën pjesë kolonel Taibe Canolli nga Policia e Kosovës, drejtori i Departamentit për ankesa pranë Inspektoratit Policor, Bajram Fetahu, këshilltarja vendore nga ICITAP për

Policinë e Kosovës, Leonora Berkani, si dhe personeli i ICITAP-it dhe instruktorët nga DEA.

Policia e Kosovës falënderoi ekipin e ICITAP-it për përkushtimin dhe mbështetjen e tyre dhe stafin e DEA-s për njohuritë dhe aftësitë e tyre që kontribuan në suksesin e trajnimit.

Shkëmbimi i ekspertizës dhe njohurive nga instruktorët avancoi aftësitë dhe shkaktësitë e pjesëmarrësve, duke kontribuar në zhvillimin e tyre profesional.



Rreth 200 ankesa të qytetarëve ndaj gjyqtarëve e prokurorëve gjatë vitit 2023

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - 126 ankesa janë paraqitur ndaj gjyqtarëve dhe 71 ndaj prokurorëve gjatë vitit 2023, ndërsa sfidë mbetet mosinformimi i duhur i qytetarëve për të adresuar ankesë. Kështu u tha në konferencën "Sfidat e zbatimit të Ligjit për përgjegjësinë të gjyqtarëve dhe prokurorëve", të organizuar nga Lëvizja FOL, me ç'rast u prezantuan gjetjet e raportit "Informimi dhe perceptimi i qytetarëve lidhur me paraqitjen e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve".

Aty u tha se 54 për qind e qytetarëve janë të painformuar se çka mund të ankohen ndaj

prokurorëve dhe gjyqtarëve, ndërsa 28 për qind kanë njohuri se ku të paraqesin kërkesat e tyre. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, paraqiti disa ndryshime në draftin aktual të projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Tha se ndryshimet vazhdojnë të jenë në fazën e gjetjeve. "Ky ligj ka për qëllim që të forcojë rolin e disiplinës së gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe rritjen e përgjegjësisë, për të krijuar një konsistencë. Është shtuar baza se prokurorët kanë pasuri të paluajtshme me vendim të gjykatave, do të bëhet paneli nga 5 anëtarë nuk do ketë më panele ad-hoc por të qëndrueshme që funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme", tha Haxhiu.

Albana Hasani nga Lëvizja FOL, bëri prezantimin e gjetjeve nga



raporti, Informimi dhe perceptimi i qytetarëve lidhur me paraqitjen e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve të prokurorëve. "53 për qind e qytetarëve janë të vetëdijshëm se mund të paraqesin ankesa ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndërsa 47 për qind të pavetëdijshëm. 126 ankesa janë paraqitur ndaj gjyqtarëve dhe 71

ndaj prokurorëve gjatë vitit 2023. 54 për qind e qytetarëve janë të pa informuar se çka mund të ankohen ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve. 28 për qind kanë njohuri kompetente se ku të paraqesin kërkesat e tyre. 72 për qind të pa informuar. 42 për qind të qytetarëve e kanë vlerësuar si procedurë të vështirë paraqitjen e

ankesave disiplinore ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve", u shpreh Hasani.

Gjithashtu Lëvizja FOL, bëri një rekomandim ndaj Këshillit Prokurorial të publikojë formularin në faqen zyrtare si ndihmesë për qytetarët që të kenë qasje më të lehtë për ankesa ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Limaj në Parlamentin e Shqipërisë, nderohet për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës



TIRANË, 11 QERSHOR - Kryetari i Nsimës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, së bashku me kryetarin e Komunitetit të Malishevës, Ekrem Kastrati dhe anëtarin e kryesisë së Nismës, Xhevahire Izmaku, kanë marrë pjesë në shënimin e 80-vjetorit të gjenocidit grek ndaj shqiptarëve të Çamërisë, që nisi në qershor të vitit 1944.

Në këtë ngjarje të rëndësishme së veçantë, që u zhvillua në sallën e Parlamentit të Shqipërisë, dhe që u bë me ftesë të deputetit shqiptar Shpëtim Idrizi dhe Shoqatës Patriotike "ÇAMËRIA", para gjithë të pranishmëve nga të gjitha trevat shqiptar, një fjalë

rasti, mbajti kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i cili tha se, kjo është njëra prej ngjarjeve më të rënda të popullit shqiptar, ku edhe pas kaq vitesh në secilën familje shqiptare kjo ngjarje, kjo histori e rëndë përjetohet me dhimbje të madhe, mu për faktin se popullata çame kishte përjetuar tmerrin e depërtimit dhe të shpërnguljes me dhunë.

"Edhe për kundër gjithë këtyre vuajtjeve që ka përjetuar popullata çame, ajo gjeti forcën për tu përballur dhe për t'i mbijetuar gjithë asaj shfarosje në masë, dhe është për t'u admiruar

që çamët fisnik për asnjë moment nuk heshtën, por vazhduar pa rreshtuar së kërkuari drejtësi, dhe që me besim presin që në të ardhmen e afërt të triumfojnë", tha kryetari Limaj.

Pas kësaj, kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, u nderuar me mirënjohje për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës, mirënjohje që në ambientet e Parlamentit të Shqipërisë iu nda nga deputeti Shpëtim Idrizi, politikani shqiptar që në vazhdimësi angazhohet në mbrojtje të të drejtave të çamëve dhe çështjes çame në përgjithësi.

Vitia thotë se shëndetësisë publike së shpejti do t'i shtohen mbi 300 punonjës të rinj

Prishtinë, 11 qershor - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka njoftuar se së shpejti shëndetësisë publike do t'i shtohen mbi 300 punonjës të

rinj. "Mbi 300 punonjës të rinj në shëndetësinë publike. Tashmë është hapur konkursi nga ShSKUK-ja për punonjës të rinj. 200 infermierë të profileve

të ndryshme si: Infermierë të përgjithshëm, mami, teknik radiologjie, teknik farmacie, laborantë mjekësor, fizioterapeutë, 20 punëtorë

mbështetës administrativ dhe 8 ndihmës. Së shpejti do të hapet konkursi edhe për rreth 70 mjekë specialistë!", ka shkruar Vitia në "Facebook".





Hovenier: Dialogu duhet të përfundojë me njohje

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se përkushtimi i ShBA-ve ndaj Kosovës dhe rajonit është i fortë dhe i qëndrueshëm. Në samitin “The Western Balkans 2024”, që po mbahet në Prishtinë, Hovenier theksoi edhe rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve që Kosova dhe Serbia kanë arritur në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Sipas tij, dialogu mes Kosovës dhe Serbisë është një sfidë që duhet tejkaluar vetëm me njohje reciproke dhe jo diçka më pak

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha se dialogu mes Kosovës dhe Serbisë është një sfidë që duhet tejkaluar vetëm me njohje reciproke dhe jo diçka më pak.

“Përfundimi i këtij procesi duhet të jetë njohja mes dy vendeve, sepse diçka më pak se kjo nuk e përmbush këtë vizionin që e kemi për një Evropë të plotë, të lirë, të begatshme dhe në paqe”, tha ai.

Duke folur në një panel të samitit “The Western Balkans 2024”, që po mbahet në Prishtinë, Hovenier theksoi edhe rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve që Kosova dhe Serbia kanë arritur në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. “Ka një varg zyrtarësh amerikanë, përfshirë dhe mua, që kalojmë shumë kohë për zbatimin e plotë të obligimeve që Kosova dhe Serbia i kanë marrë në procesin e lehtësuar nga BE-ja”, tha Hovenier.

Dy vendet janë në negociata për më shumë se një dekadë, por shumë prej marrëveshjeve që kanë arritur, nuk i kanë zbatuar.

Të dyja palët fajësojnë njëra-tjetrën për mungesë gatishmërie.

Hovenier theksoi edhe një herë

qëndrimin e tij se nuk pajtohet me një deklaratë - të miratuar më 8 qershor nga Serbia dhe entiteti serb i Bosnje e Hercegovinës, Republika Sërpska - në të cilën Kosova trajtohet si “pjesë e patjetërsueshme e Serbisë”. “Ky nuk është qëndrim i vendit tim apo i partnerëve. Ne e kemi njohur Kosovën si vend të pavarur demokratik dhe kjo nuk mund të diskutohet”, tha Hovenier.

Të njëjtën gjë ai e tha edhe një ditë më herët, duke kujtuar se ShBA-ja e ka njohur Kosovën si shtet të pavarur dhe se ajo do të mbetet prapa këtij qëndrimi “me krenari”.

Kurti: Problemin e kemi me Beogradin, jo me serbët e Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se Qeveria e drejtuar prej tij nuk ka problem me serbët e Kosovës, por me Qeverinë e Serbisë.

Duke folur në samitin “The Western Balkans 2024”, të martën në Prishtinë, Kurti tha se integrimi i serbëve të Kosovës në institucionet e vendit, është çështje parësore për të. “Problemi që kemi, nuk ka të bëjë me serbët. Problemin e kemi me Beogradin, i cili nuk u distancau as nga Millosheviqi i së



kaluarës e as nga Putini i së tashmes”, tha Kurti duke iu referuar ish-presidentit jugosllav dhe presidentit aktual rus.

Serbët në veri të Kosovës, të ndikuar nga Beogradi dhe strukturat e tij paralele në Kosovë, kundërshtojnë vazhdimisht autoritetin e Qeverisë në Prishtinë. Shpesh organizojnë protesta ose bojkotojnë vendimet e autoriteteve kosovare.

Në nëntor të vitit 2022, ata dolën nga institucionet e Kosovës në veri, në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së vendit për t'i reregjistruar makinat me targa ilegale serbe.

Kurti tha të martën se Kosova po bën tashmë konvertimin e patenshoferëve, diplomave e targave të makinave, si hapa për integrimin e komunitetit serb. Por, Qeveria e tij është nën presionin e ndërkombëtarëve për të formuar Asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Për këtë asociacion, Kosova dhe Serbia u dakorduan qysh në vitin

2013.

Marrëveshja mes tyre u miratua edhe në Kuvendin e Kosovës, por Gjykata Kushtetuese konstatoi më pas se ajo ishte jokushtetuese, meqë nuk përfshinte edhe etnik të tjera.

Pavarësisht garancive nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian, Kosova nuk e zbatoi marrëveshjen nga frika se një asociacion i tillë do të ndikonte në funksionimin e shtetit. Serbia, e cila e konsideron Kosovën ende pjesë të veten, nuk ka zbatuar ngjashëm një varg marrëveshjesh me Kosovën.

Ish-sekretari i NATO-s: Rusia po investon në destabilizimin e Ballkanit Perëndimor

Ish-sekretari i NATO-s, Lord George Robertson ka deklaruar se lufta në Ukrainë është një kërcënim ekzistencial për Perëndimin e gjithashtu edhe për

Ballkanin Perëndimor.

Ai në samitin “The Western Balkans 2024”, është shprehur se rreziku nga ndikimi rus ekziston, por kjo sipas tij nuk e përfshin vetëm kërcënimin ushtarak dhe se ndikimi i Rusisë “po i dobëson edhe institucionet e vendeve demokratike”.

“Rusia dhe aleatët e saj si Kina, Irani, mund të përdorin teknika të dobësimit të shoqërive tona. Lufta kibernetike dhe ndërhyrjet në zgjedhje po vazhdojnë dhe po i dobësojnë institucionet tona demokratike. Duhet të zgjohemi për faktin se nëse Putini fiton në Ukrainë, mund të presim të shohim më shumë nga kjo në të ardhmen”, ka thënë Robertson.

Ish-sekretari i NATO-s shtoi se Rusia po investon “në luftën e sektorit të hirit”, dhe se sipas tij, ky investim po bëhet edhe në Ballkanin Perëndimor.

Robertson ka përmendur përfshirjen Perëndimore gjatë viteve të ‘90-ta për të ndaluar luftërat dhe spastrimin etnik të regjimit të Slllobodan Millosheviqit ndaj shqiptarëve. “Ishim të detyruar ndërmerrim sërish veprime ndaj forcave paraushtarake të Slllobodan Millosheviqit, që u përpoqën të bënin spastrimin etnik të Kosovës. Kur unë isha ministër i Mbrojtjes i Mbretërisë së Bashkuar, bëra të qartë se forcat e Millosheviqit duhet të largoheshin dhe refugjatët të ktheheshin. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të theksohet se përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare, ishte një bazë e rëndësishme për stabilitetin politik dhe prosperitetin ekonomik”, ka thënë ai.

GAP-i organizoi tryezë diskutimi ku publikoi raportin "Nevoja për themelimin e një institucioni të pavarur fiskal në Kosovë"

Prishtinë, 11 qershor- Instituti GAP ka organizuar të martën tryezë diskutimi ku publikoi gjetjet e raportit "Nevoja për themelimin e një Institucioni të Pavarur Fiskal në Kosovë".

Rrona Zhuri nga Instituti GAP, prezantoi gjetjet e raportit ku theksoi se institucionet e pavarura fiskale të themeluara në shumë vende të botës luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e politikave fiskale, mbajtjen e stabilitetit fiskal dhe përgatitjen/monitorimin e parashikimeve makroekonomike. Në Kosovë, ndër vite janë

shfaqur sfida në proceset buxhetore dhe fiskale si mospërputhja e dokumenteve buxhetore afatmesme me ato vjetore dhe vlerësimi buxhetor i politikave të reja pa ndonjë analizë më të thellë. Instituti GAP propozon tri opsione të mundshme për themelimin e një institucioni fiskal të pavarur në Kosovë: 1) institucion fiskal i pavarur si institucion i ndarë, 2) zyrë parlamentare në kuadër të Kuvendit të Kosovës, ose 3) institucion fiskal në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Për më shumë, themelimi i një

institucioni të tillë duhet të bëhet sipas kërkesave minimale të caktuara nga direktivat e Komisionit Evropian, si dhe parimeve kyçe të caktuara nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), të ketë pavarësi të plotë duke pasur edhe procese të rekrutimit të paanshme, si dhe të përfshihet themelimi i tij në proceset e buxhetit.

Sanja Madzarevic, ekonomiste e lartë për Ballkanin Perëndimor në Bankën Botërore, theksoi se parimet me të cilat duhet të funksionojnë institucionet e

pavarura fiskale janë pavarësia, komunikimi i hapur dhe llogaridhënia, si dhe qasja e hapur në informata.

Abdylmenaf Bexheti, anëtar i Këshillit Fiskal të Maqedonisë së Veriut, vlerësoi se Kosova ka avantazh ta themelojë një këshill fiskal për shkak edhe të hapësirës së madhe fiskale, pra borxhit të ulët publik. Pavarësia, integriteti, kompetencat dhe profesionalizmi i personave të zgjedhur për të vepruar në këtë institucion duhet të jetë kyç.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit Parlamentar për

Mbikëqyrjen e Financave Publike, theksoi se para themelimit të një institucioni të tillë, duhet të ketë debat të gjerë publik, që të arrihet konsensus dhe zotim, që rekomandimet që do të jepen do të merren parasysh.

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit, shtoi se shteti duhet të ketë të dhëna të sakta për një menaxhim në të mirë të buxhetit të shtetit dhe se Kosova duhet t'i forcojë mekanizmat ekzistues për më shumë kontrolle buxhetore.



Shqyrtohet raporti i auditimit për pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2023

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Në mbledhjen e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, drejtuar nga kryetarja Hykmete Bajrami, u shqyrtua raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Radio Televizionit të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Prezentë në këtë takim ishin anëtarë të bordit të RTK-së, si dhe drejtori i përgjithshëm i RTK-së.

Fillimisht, në cilësinë e deputetit raportues, anëtar i Komisionit, Hajdar Beqaj, duke shpalosur raportin e auditorit dhe duke sqaruar se është me opinion të kualifikuar, numëroi disa nga mangësitë e hasura nga auditori. Ai tha se të gjeturat janë shqetësuese, ndërsa kërkoi detaje nga përfaqësues të RTK-së, me theks të veçantë rreth shfrytëzimit të pronës së RTK-së, e cila është nën menaxhimin e

AKP-së.

Ai vlerësoi se bazuar në këtë raport është hasur edhe mangësia në procesin e rekrutimit. Ndërkaq, raporti i auditimit ka rezultuar me shtatë rekomandime, gjashtë rekomandime të reja dhe një sosh pjesërisht i përsëritur. Beqaj po ashtu sqaroi se nga RTK janë pajtuar pjesërisht me të gjeturat e auditorit, duke kërkuar tutje të dhëna për mospajtueshmërinë, si dhe detaje tjera për çështjen e pronës.

Pas prezantimit të raportit, kryetari i bordit të RTK-së, Besnik Boletini, theksoi auditori i ka ndihmuar ata drejt përmirësimit të situatës dhe se janë zbatuar rekomandimet e vitit paraprak.

Ndërkaq, sa i përket çështjet se pronës së RTK-së ai tha se kjo e gjetur do të përsëritet meqë ata



nuk mund të bëjnë diçka rreth kësaj çështjeje, ngase, sipas tij, nuk kanë fuqi ta ndryshojnë këtë proces.

Sa i përket çështjes së procesit të rekrutimit të stafit, Boletini e konsideroi si shqetësuese dhe bëri të ditur se janë ndërmarrë masa dhe po ashtu është hartuar

rregullorja.

Në vijim ai foli edhe lidhur me çështjet tjera të cilat janë adresuar dhe se tashmë kanë fuqizuar edhe njësinë e auditimit të brendshëm. Ai po ashtu vlerësoi se shumë shpejt do të përfundojë edhe plani i zbatimit të rekomandimeve.

Pasi u diskutua edhe për bazën e kundërshtimit të të gjeturës nga ZAP-i, sqarime dhanë edhe përfaqësues të Zyrës së Auditorit.

Edhe drejtori i përgjithshëm i RTK-së, Shkumbin Ahmetxhekaj, sqaroi gjetjet tjera, me theks të veçantë rastin e kontratës me kompensim, që sipas tij ishte një gabim teknik. Ndërkaq, tutje foli edhe për çështjet e konkurseve dhe detaje tjera, duke u përgjigjur në shqetësimet që u ngritën nga anëtarë të Komisionit lidhur me raportin e auditorit, por edhe për çështje jashtë këtij raportit.

Pas shterimit të diskutimit, kryetarja e Komisionit, Hykmete Bajrami, tha se derisa RTK financohet nga taksat e qytetarëve, qëllimi kryesor i tyre duhet të jetë informimi, edukimi dhe arsimimi përmes skemë programore.

Kurti dhe Robertson marrin pjesë në hapjen e ekspozitës fotodokumentari “KFOR and Kosovo + 25”

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, vizitoi ekspozitën e fotodokumentarit “KFOR and Kosovo + 25” që shënon edhe 25-vjetorin e hyrjes së trupave të KFOR-it në Kosovë, ekspozitë kjo që po shfaqet në ambientet e Muzeut Kombëtar të Kosovës.

Kryeministri Kurti fillimisht iu prezantua ekspozita me fotografi të fotografit Nick Sidle, nga organizatorja e organizatës “Heartstone” Sita Kumari. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti tha se ende ishte nën mbresat e këtyre fotografive të kësaj ekspozite që porsa i pa në një mënyrë të dyfishtë; e para për shkak se jemi në vigjilje të 25-vjetorit të çlirimit e të paqes, të hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë; dhe së dyti, për shkak se dy vitet e gjysmë të para të lirisë, ai ka qenë rob luftime. “Nga i burgosur politik me datën 10 qershor, bëhem rob luftime. Janë ato dy vjet e gjysmë të para të cilët nuk i di për shkak se kam qenë i mbyllur dhe i izoluar, dhe të gjitha këto ekspozita



dhe shfaqje e paraqitje të cilat na kthejnë 25 vjet përpara nuk janë të tilla që më rikujtojnë mua sa më mësojnë për atë që më mungon. Andaj falënderoj me mirënjohjen më të thellë organizatoren për këtë”, tha ai.

Duke kujtuar ditët e luftës, kryeministri theksoi se kjo ekspozitë njëmend na kthen pas, në muajt e parë të lirisë dhe sjellë në pah një periudhë historike të rëndësishme për të gjithë neve, na e sjellë kontrastin ndërmjet çnjerëzores së një regjimi dhe

bukurisë së hirshme të njerëzimit. “Në veçanti në këtë ekspozitë mund të shihni jetën e rëndomtë të njerëzve në situata të ndryshme të cilat njerëzorja i bën të njëjta. Pra, do të mund të shihni jo ngjarjet e jetës që e bëjnë jetën ngjarje të mirë dhe ky fotodokumentim unik nga fotografi e gazetari Nick Sidle, është një testament për guximin dhe sakrificat e atyre që kanë kontribuar për paqe në vendin tonë”, veçoi ai.

Teksa komentonte fotografitë,



kryeministri theksoi se është një mundësi për të reflektuar mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe kontributin e çmuar të KFOR-it në substancë të së cilës ishte NATO-ja.

Krahas atyre që kanë kontribuar në këtë ekspozitë, kryeministri shprehu mirënjohje e përgjithshme për të gjithë paqeruajtësit që kanë shërbyer e shërbejnë në Kosovë. “Kontributi juaj është i pamatshëm dhe i paharrueshëm”, tha ai.

Fjalë rasti mbajtën edhe Lord George Robertson, ish-Sekretar i

Përgjithshëm i NATO-s dhe ministër i Mbrojtjes në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves.

Në këtë ekspozitë, kryeministri shoqërohej nga zëvendëskryeministret, Donika Gërvalla dhe Emilija Rexhepi si dhe ministrat, Hajrulla Çeku, Elbert Krasniqi dhe Rozeta Hajdari. Ekspozita “KFOR and Kosovo + 25” po shfaqet në kuadër të agjendës shtetërore për shënimin e 25-vjetorit të çlirimit të vendit.

AGK-ja nderon gazetarë, kameramanë e fotoreporterë që raportuan në rrethana okupimi

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Në nder të shënimin të 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, nderoi gazetarë, kameramanë e fotoreporterë vendorë e ndërkombëtarë, për kontributin e jashtëzakonshëm në gazetari, në rrethana okupimi, para dhe gjatë luftës në Kosovë 1998-99. Fjalën hyrëse të ceremonisë e mbajti kryetari i Bordit, Xhemajl Rexha, i cili u shpreh falënderues e mirënjohës për punën shembull që gazetarët, kameramanët e fotoreporterët e kanë dhënë në atë kohë.

“Ajo çfarë AGK-ja, dëshiron të tregojë me këtë event, është që e çmojmë, e njohim punën e kontributin e secilit në periudhën më të vështirë të Kosovës. Të secilit, që ndoshta ka bërë punë nga më të voglat në redaksi e deri tek ato në terren, dhe me ballafaqimin me rrezikun e përhershëm. Ju jeni inspirim për gjenerata të tëra gazetarësh”, ka thënë Rexha.



Të pranishmëve iu drejtuan edhe gazetarja Afërdita Saraçini-Kelmendi, moderatorja Besa Çeku-Buçinca, Nuhi Bytyçi - gazetar i luftës, Sylejman Kllokoqi - kameraman i AP, Visar Kryeziu - fotoreporter i AP, Hazir Reka - fotograf i Reuters, si dhe Ron Haviv - fotografi i mirënjohur botëror i cili ka qenë dëshmitar i ngjarjeve historike që kanë definuar kohën në të cilën jetojmë, nga Kosova, Bosnja, Ukraina, etj. Saraçini Kelmendi, tha se gazetarët në atë kohë kanë bartë me vete

frikën për jetë e familje. “Gazetaria më e bukur për mua është gazetaria e terrenit për shkak se aty takon njerëz, fate të cilat të japin përvoja jetësore, në këtë rrugëtim 45-vjeçar i kam hypur 44 shkallë të gazetarisë, gazetaria për mua nuk është vetëm profesion është edhe mënyrë e jetesës. Të gjithë gazetarët që kanë punuar para dhe gjatë luftës kemi bartur edhe frikën për jetën, familjen”, tha ajo.

Kameramani, Sylejman Kllokoqi, falënderoi kolegën Elida Ramadanin, me të cilën kanë ndarë

shumë terrene, si dhe gazetarët botërorë që kanë raportuar nga Kosova.

“Iu dëshiroj gjeneratave sukses, por të ju them se ne e kemi pasur detyrë por një falënderim shkon për gazetarët që kanë ardhur nga gjithë bota”, tha Kllokoqi.

Zëri ikonë i lajmeve, Besa Çeku-Buçinca, tha se çmon lartë kontributin e kolegëve gjatë kohës së luftës. “Të dashur kolegë, shumë pak janë të informuar për punën tonë dhe aq më pak e vlerësojnë atë ne kohët e vështira, detyra jonë ishte që të informonin, informimi që barte shumë rrezik, gazetarët kanë kaluar në rreziqe të shumta, megjithatë e vlerësoj shumë punën e gazetarëve në terren.”

Fotoreporterit amerikan, Haviv falënderoi AGK-në për ftesën e bërë për të folur në emër të gazetarëve, kameramanëve e fotoreporterëve ndërkombëtarë që kanë raportuar nga Kosova në atë kohë. Teksa, ndau me të pranishmit një takim

menjëherë pas luftës me zvpresidentin Al Gore, kur kishin diskutuar për impaktin e punës së gazetarëve në Kosovë. “Derisa i tregova për punën time që kisha bërë në Kosovë, ai më pyeti se përse ShBA-të, intervenuan më shpejtë në Kosovë, sesa në Bosnjë e Hercegovinë. Është për shkak të gazetarisë që prodhohej nga Kosova, sepse ata, ai (Al Gore), Tony Blair, Bill Clinton, ishin të turpëruar të shihni të njëjtat fotografi si në Bosnjë, duke lexuar të njëjtat histori..., dhe intervenimi në Kosovë, është një nga të paktat storie, të paktën në mendjen time, që gazetaria luan një rol të rëndësishëm, e direkt në atë se çka ka ndodhur këtu”, tha ai.

Në këtë ceremoni, me mirënjohje u nderuan mbi 400 gazetarë, kameramanë e fotoreporterë, nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut, si dhe ata ndërkombëtarë që kanë raportuar në atë kohë nga Kosova.

Krasniqi për konferencën e LDK-së: Aty u promovua ‘Rruga e re’, duke i ndarë rrugët me Rugovën

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Milazim Krasniqi, njeri nga themeluesit e LDK-së, e ka kritikuar konferencën që kjo parti e ka mbajtur një ditë më parë për ish-presidentin Ibrahim Rugovë. “LDK-ja dje ka mbajtur konferencë të çuditshme për Ibrahim Rugovën. Kanë folur disa njerëz që realisht nuk e kanë

njohur Rugovën dhe as vizionin e tij politik, kombëtar e humanist. Kushdo që ftohet nga organizatori ka të drejtë të flasë, qoftë dhe mbarë e mbrapshtë siç kanë folur disa dje. Por LDK-ja nuk ka të drejtë morale të ftojë gjithsekënd, nëse synon të mbetet si vazhduese e vizionit të Rugovës. Ama konferenca e

djeshme më shumë u duk si tubim komemorativ për trashëgiminë e Rugovës në LDK. Dje aty u promovua ‘Rruga e re’, duke i ndarë rrugët me Rugovën. Po të ndiqej nga Abdixhiku vizioni i Rugovës, nuk do të shpallej ‘rruga e re’. ‘Rruga e re’ është shkëputje nga rruga e vjetër e Rugovës. Është një ‘Rilindje’ brenda

LDK-së siç e ka bërë Rama ‘Rilindjen’ brenda PS-së. Me gjasë Rama është ftuar në konferencë, për të sjellë përvojat e tij ‘rilindase’. I vetmi problem në këtë eksperiment është që LDK-ja nuk është si PS-ja dhe as Abdixhiku nuk mund të bëhet si Rama”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.



PE-ja do ta vazhdojë mbështetjen për zgjerimin, rreziku qëndron te disa vende anëtare

Prishtinë, 11 qershor - Frika nga ndonjë rritje e madhe e së djathtës ekstreme në Parlamentin Evropian (PE) nuk u realizua.

Zgjedhjet për këtë institucion u mbajtën nga data 6 deri më 9 qershor.

Përkundër përparimit relativisht të vogël të partive të ekstremit të djathtë në disa vende, partitë që konsiderohen tradicionalisht proevropiane, do ta kenë shumicën edhe në përbërjen e re të PE-së.

Për diplomatët në Bruksel, ky është lajm i mirë edhe për procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian, por edhe për raportet e BE-së me Ballkanin Perëndimor, sepse, sipas tyre, edhe në përbërjen e re të PE-së do të ketë një shumicë të mjaftueshme të deputetëve, që do të vazhdojnë t'i mbështesin këto politika.

Sipas rezultateve të deritashme - e as përfundimtare nuk pritet të sjellin ndonjë ndryshim dramatik - grupimet kryesore politike, me disa ndryshime, i kanë ruajtur pozicionet që i kanë pasur edhe më herët.

Partia Popullore Evropiane (PPE) pritet t'i ketë 186 vende në Parlamentin me 720, që nënkupton dhjetë vende më shumë se në përbërjen e deritashme.

Grupimi socialist S&D do t'i ketë 135 vende, apo katër më pak se në periudhën 2019-2024.

Liberalët nga grupi Renew pritet t'i kenë 79 vende, që do të thotë 23 më pak se në përbërjen e deritashme, ndaj mund të konsiderohen edhe si humbës të mëdhenj.

Megjithatë, së bashku, këto tri grupe pritet ta kenë shumicën, me rreth 400 vende, dhe nëse merren vesh, mund ta sigurojnë numrin e votave për vendimet kryesore të BE-së, përfshirë edhe zgjerimin.

Në favor të zgjerimit, pos partive të përmendura janë edhe grupi i Të Gjelbërve që do t'i ketë 53 vende në PE dhe grupi i partive konservatore ECR me 73 vende.



E vetmja parti që ka qenë kundër zgjerimit, është Identiteti dhe Demokracia (ID), që pritet t'i ketë 58 vende në PE. Ajo mund të rritet, varësisht se cilat parti do t'i bashkohen, por, prapëseprapë, nuk do ta vinte në rrezik mbështetjen për procesin e zgjerimit nga ana e PE-së.

Për shumë vite, e sidomos me përbërjen e fundit, Parlamenti Evropian ka qenë institucioni i BE-së, i cili më së shumti ka mbështetur procesin e zgjerimit. Ai ka kërkuar që ky proces edhe të përshpejtohet, apo që vendet candidate të përfshihen në programet dhe strukturat e Bashkimit Evropian edhe përpara se të bëhen anëtare formale të bllokut.

Parlamenti Evropian shpesh edhe i ka kritikuar vendet anëtare për mospëmbushje të obligimeve që BE-ja i ka marrë në raport me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe vendet e tjera që aspirojnë anëtarësimin në BE.

Para se të përfundonte puna e Parlamentit të fundit Evropian, në

këtë institucion është miratuar edhe një propozim për reformat e BE-së, në mënyrë që të mundësohet zgjerimi më i shpejtë i saj.

Mes masave, PE-ja ka propozuar edhe miratimin e disa vendimeve me shumicë të kualifikuar në Këshillin e BE-së, në mënyrë që të mos ketë bllokada të shpeshta nga ana e disa vendeve anëtare, të cilat e shfrytëzojnë anëtarësimin e tyre në BE për të penguar avancimin e vendeve fqinje, për shkak të mospajtimeve bilaterale.

Në bazë të shpërndarjes së vendeve në përbërjen e re vlerësohet se kjo mbështetje e PE-së do të vazhdojë edhe në pesë vjetet e ardhshëm.

Por, problem për zgjerimin mund të paraqesë rritja e ndikimit të partive të ekstremit të djathtë në disa vende anëtare të Bashkimit Evropian.

Disa diplomatët në Bruksel, me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë, tërheqin vërejtjen se mund të ketë ndryshime në qasjen e disa shteteve.

Kjo është e mundshme, pasi

vendimet për secilin hap në procesin e zgjerimit merren në Këshillin e BE-së, përkatësisht me konsensusin e të gjitha vendeve anëtare.

Holanda përmendet si një vend që mund të paraqesë probleme në të ardhmen në këtë drejtim, pasi atje pritet të formohet Qeveria, në krye të së cilës do të jetë për herë të parë e djathta ekstreme, më saktësisht Partia e Lirisë e udhëhequr nga Gert Wilders. Kjo parti ka pasur qasje kritike ndaj zgjerimit dhe e ka kundërshtuar atë.

Holanda nuk pritet ta ndryshojë në mënyrë dramatike qasjen, sepse partia e ekstremit të djathtë është dashur të bëjë kompromise, por është paralajmëruar se do të kërkojë që, në rast të zgjerimit, të ketë kufizime për vendet e reja anëtare dhe qytetarët e tyre në çështje si: liria e lëvizjes së punëtorëve në tregun e përbashkët dhe qasja në disa fonde të BE-së.

Kufizimet e tilla, përtej asaj që mundësojnë traktatet aktuale të BE-së, nuk janë të mundshme formalisht. Por, këto insistime

tregojnë se në çfarë drejtimi mund të shkojnë qëndrimet e disa vendeve anëtare.

E djathta ekstreme ka shënuar rritje edhe në Austri dhe Belgjikë, ndërsa ka fituar në Francë. Prandaj, rreziku potencial për procesin e zgjerimit të BE-së shihet te qëndrimet e vendeve anëtare, e jo te numri i vendeve që partitë e ekstremit të djathtë kanë siguruar në përbërjen e re të Parlamentit Evropian.

Disa deputetë nga përbërja e vjetër e PE-së, që janë rizgjedhur, por nuk duan të flasin publikisht për të respektuar formalisht procesin e konfirmimit zyrtar të zgjedhjes së tyre, besojnë se Parlamenti do të jetë një zë i fuqishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe për procesin e zgjerimit.

Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës, të gjitha ose kanë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, ose kanë nisur tashmë negociatat e pranimit.

Kosova vetëm ka aplikuar për anëtarësim në fund të vitit 2022.

LV-ja kujton aktivistin Arbënor Dehari

Prishtinë, 11 qershor - "10 vjet pa më të dashurin shok, aktivistin tonë të pazëvendësueshëm, Arbënor Dehari", ka shkruar në "Facebook" Lëvizja Vetëvendosje.

Më tej thuhet se Arbënor Dehari vazhdon të jetë figurë qendrore dhe orientuese në angazhimin dhe ecjen tonë politike. "Java e Lëvizjes në krye të saj e ka Arbënor Deharin jo vetëm si kujtim dhe nderim për një aktivist të jashtëzakonshëm por edhe si tregues, si frymëzim për brezat e ardhshëm. Arbënor

Dehari na kujton se konceptet e vetëvendosjes, lirisë, barazisë, drejtësisë dhe solidaritetit nuk janë thjeshtë ideale të dëshiruara apo fjalë të thjeshta, por edhe detyrime për të cilat njeriu zotohet, angazhohet dhe punon përgjatë jetës së tij. Me angazhimin e tij të palëkundur, me guximin e tij të pashoq, me pasionin dhe përkushtimin e tij, Arbënor Dehari, ishte aktivisti që më së shumti anëtarësonte njerëz në Lëvizjen Vetëvendosje!. Në këtë kuptim, ditën e dytë të javës



tradicionale të Lëvizjes për këtë vit, përveç si ditë ku e nderojmë kujtimin për Arbënorin, e kemi caktuar të jetë edhe ditë e anëtarësimeve të reja në Lëvizjen tonë. Kujtimi për Arbënorin do të jetë përherë i gjallë mes nesh, i mbushur me aktivitete, i theksuar nga mësimi se idealizmi dhe veprimi i guximshëm janë forcat që ndërtojnë një të ardhme për të gjithë. Përjetësisht në zemrat dhe mendjet tona do të jesh Arbënor Dehari!", është thënë në njoftimin e LV-së.

“Trepça” kërkon kthimin e pronave të paluajtshme, jep afat 30 ditë

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Ndërmarrja “Trepça Sh.A” ka kërkuar kthimin e pronave të tyre të paluajtshme. Sipas njoftimit thuhet se menaxhmenti i ndërmarrjes ka ndërmarrë hapa për të siguruar dëshmi të pronësisë dhe ka bërë thirrje për bashkëpunim nga të gjitha subjektet. “Menaxhmenti i tanishëm është duke u angazhuar me seriozitetin maksimal në ringritjen e saj

drejt një gjiganti ekonomik. Po punojmë në rishikimin e infrastrukturës ligjore e cila synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes hapjes së rrugës për investime, rritjen e vlerës së aseteve dhe avancimin e kapitalit tekniko-teknologjik si parakusht për rivitalizimin e Trepçës si një ndërmarrje me rëndësi të veçantë, jetike për mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e

përgjithshëm publik. Në të njëjtën kohë së bashku me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe zyrat regionale kadastrale jemi duke siguruar dëshmi të pronësisë e ‘shoqërisë’, thuhet në njoftim. Menaxhmenti i “Trepça Sh.A.” u ka drejtuar një kërkesë publike të gjitha subjekteve juridike dhe fizike, organizatave të shoqërisë civile dhe

subjekteve të tjera që aktualisht sipas tyre, po shfrytëzojnë pronat e paluajtshme të ndërmarrjes, që brenda një afati 30-ditor, deri më 10 korrik, të kontaktojnë zyrat e menaxhmentit në Parkun Industrial në Mitrovicë. “Të gjitha këto prona do t’i kthehen në shfrytëzim ndërmarrjes, me ç’rast disa prej tyre do t’i lëshojmë me qira e disa do t’i përdorim për



zhvillimin e kapaciteteve të reja. Me qëllim të realizimit të këtyre objektivave, në rend të parë kthimin e pronave tek pronari, Menaxhmenti i ‘Trepça Sh.A.’ ka vendosur që t’i drejtohet opinionit publik me një kërkesë”, thuhet në njoftimin zyrtar.

Kurti takohet me përfaqësues të grupit të inovacionit “Yes-EU”, flasin për investime në energji

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Në margjina të samitit të Ballkanit Perëndimor të organizuar nga The Economist Group, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u takua me përfaqësues nga grupi i inovacionit “Yes-EU”. Delegacioni i këtij grupi udhëhoqej nga drejtuesi Benedikt Gudmundsson, e ku pjesëmarrës ishte dhe ish- ministri i Punëve të Jashtme të Islandës, Össur Skarphéðinsson. Kurse kryeministri Kurti, në këtë takim ishte i shoqëruar nga ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe Shefi i Stafit, Luan Dalipi. Grupi “Yes-EU” është i njohur

ndërkombëtarisht në fushën e inovacionit për projekte të ndryshme të zbatuara, të fokusuar dhe specializuar në projekte të energjisë, me theks në tranzicionin drejt energjisë së ripërtëritshme si dhe transportit të gjelbër. Kryeministri Kurti i uroi mirëseardhjen në Kosovë dhe shprehu mirënjohjen për interesimin e tyre për ta njohur vendin tonë dhe hulumtuar mundësitë për investime në vend. Kryeministri i prezantoi përfaqësuesit e “Yes-EU” me zhvillimin e progresin ekonomik që ka njohur vendi ynë në tri vitet e fundit e veçanërisht avancimet

në fushën e energjisë dhe teknologjisë, përkatësisht investimet në këto sektorë. Ai shprehu përkushtimin e Qeverisë për investime të gjelbra me synim reduktimin e emetimit të karbonit dhe promovimin e mobilitetit të qëndrueshëm urban, me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Duke i ftuar që të investojnë në Kosovë, si një vend që ofron hapësirë të volitshme të zhvillimit, të prodhimit të energjisë së gjelbër dhe avancimit të teknologjisë, kryeministri i uroi grupit “Yes-EU” qëndrim të frytshëm e takime sa më produktive.



ZKA-ja publikon raportet e auditimit për gjashtë ministri

Prishtinë, 11 qershor- Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar gjashtë raportet e para të auditimit për Ministrinë, si: Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT); Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD); Ministrinë e Ekonomisë (ME); Ministrinë e Mbrojtjes (MM) si dhe për Ministrinë e Shëndetësisë (MSH). Bazuar në rezultatet e auditimit ZKA-ja ka dhënë opinion të kualifikuar për MINT, MBZHR dhe MSH. Arsyeja e modifikimit, përkatësisht kualifikimit të opinionit për këto Ministri është për shkak se Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2023 nuk kanë



prezantuar pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Kurse MPJD, ME dhe MM opinionin e auditimit e kanë të

pamodifikuar për shkak se ZKA ka marrë siguri të arsyeshme se Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2023 prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë. ZKA, gjithashtu për këto Ministri ka prezantuar edhe konkluzionin në lidhje me pajtueshmërinë duke vlerësuar nëse transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Nga auditimet e kryera ka rezultuar që MBZHR dhe ME të kenë konkluzion të kualifikuar për shkak se disa nga transaksionet e

kryera nuk kanë qenë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit. Përdorimi MINT, MPJD, MSH dhe MM konkluzionin e pajtueshmërisë e kanë të pamodifikuar për shkak se ZKA ka marrë siguri të arsyeshme se transaksionet e kryera kanë qenë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit. Përkundër gjetjeve të shpalosura në raporte të auditimit, këto ministri kanë shënuar progres sa i përket nivelit të zbatimit të rekomandimeve. Gjithashtu, kemi rënie tek numri i rekomandimeve të dhëna, për 17 rekomandime më pak. Për vitin 2022 ishin dhënë 49 rekomandime, ndërsa për vitin 2023 janë dhënë 32.

Shpenzimet e subvencioneve për eficiencë, reagon Ministria e Ekonomisë

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Ministria e Ekonomisë ka reaguar pas lajmit të publikuar në disa media lidhur me shpenzimet e parave për pajisje për eficiencë nga ana e qytetarëve. Ministria e Ekonomisë thotë se në artikullin e publikuar në RTV Dukagjini thuhet shumë të pavërteta për procesin e subvencionimit të masave të

eficiencës së energjisë për qytetarët (familjet) dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. “Ju njoftojmë se i gjithë procesi i subvencionimit të eficiencës së energjisë ka kaluar përmes një transparence të plotë, pa keqpërdorime, nga i cili proces kanë përfituar qytetarët, ku janë arritur rezultate të dukshme në kursimin e energjisë, pasi

qytetarët dhe bizneset janë pajisur me pajisje eficiente, duke paguar më pak për to”, thuhet në reagim, duke theksuar se Ministria e Ekonomisë shpalljen e thirrjeve publike për subvencionim të eficiencës së energjisë, e ka bërë përmes konferencave, takimeve me qytetarë e përfaqësues të bizneseve dhe përmes fushatave informuese në media e rrjete sociale.



BRENGA

Tregim nga: Franz KAFKA
Përktheu: Agron TUFA

Kur më pati ardhë në majë të hundës – kjo ka bërë vaki në muzgjet e nëntorit – dhe unë ngarendja nëpër rrugicat prej qylimi si në një pistë vrapimi andej-këndeje brenda dhomës sime, dhe, teksa dalloja në dritore rrugicën e ndriçuar, tutesha, ktheja praptazi dhe, përthellë pasqyrës në skajin tjetër të dhomës përftoja një objektiv të ri, ia jepja piskamës veç për të dëgjuar piskamën, ani pse mirë e dija, se asaj kush s'i kthen përgjigje dhe asgjë nuk e dobëson, se piskama lind dhe s'ka kush ta ndalojë, se ajo s'ka sosje, madje dhe kur të shuhet – atëbotë befash drejt e në mur u çel një derë, u hap nxitimthi, sepse duhej nxituar, e madje kuajt e kaloshinave në rrugë brofën kas përpjetë duke hingëllirë, sikundërse çmenden kuajt në luftë. Ç'prej korridorit të kredhur në terr, në të cilin ende nuk qenë ndezur llambat, u shfaq, mu si një fantazmë e vocërr një kalama dhe u ngrit majë gishtash mbi një shkorsë që lëkundej mezidukshëm. Drita e mugët në dhomë i vrau sytë dhe deshi të mbulojë fytyrën me pëllëmbë, por papritmas u qetua, këqyri në dritore, matanë të cilave terri kishte mbledhë, së mbrami, tymin e kaltër të fanarëve, që qe ngritur shumë lart. Duke fshikur murin me bërrylin e djathtë, kalamani qëndroi në derë të hapur mes korrentit, dhe era ia frushullonte këmbët, qafën, tëmthat.

E pashë me bisht të syrit, mandej i thashë: "mirëdita!" – dhe mora nga ekrani para sobës setrën, ngase s'desha të qëndroja gjysmë i zhveshur. Hapa gojën saora të shfryja trazimin. Në gojë kisha një shije të keqe, më dridheshin qerpikët, thënë shkurt, nuk më mjaftonte veçse kjo vizitë, sidoqë ç'prej kohësh e parandjerë.

Kalamani ende vazhdonte të qëndronte ndanë murit, në po atë vend, ai prekte murin me pëllëmbën e djathtë dhe, kuqëluar prej kënaqësisë, gërryente me majën e gishtave suvanë fërmuese të murit. E pyeta:

– Menjëmend tek unë keni ardhë? Mos jeni drejtue gabim? Në një ndërtesë të madhe si kjo, gabimi është gjithëherë i mundshëm. Unë jam filani dhe banoj në katin e katërt. Kështu pra, ju deshët me u pa pikërisht me mua?

– Kadalë, kadalë, – tha shkujdesshëm kalamani, – gjithçka në rregull është.

– Atëherë hyni brenda, unë desha me e mbyllë derën.

– Po unë tanimë e mbylla. Mos e vini veten në siklet. E di ç'keni, qetësohuni.

– Për çfarë sikleti e keni? Po, në korridor ka shumë banorë, dhe unë, ta pret mendja, me të gjithë njihem; nëse ata do të dëgjojnë se këtu kuvendohet, thjesht do ta quajnë të



arsyeshme të hapin derën dhe të shohin ç'ngjet këtu. Kësaj s'ke ç'i bën. Dita e punës mbaroi; ata përkohësisht janë të lirë, dhe nuk do të ma varin dhe fort mua! Paj dhe vetë e dini kaq pakogjë. Lermëni ta mbyll vetë.

– Eh, e çë pastaj? Çfarë, menjëmend e keni? Sa për mua, lë të hyjë gjithë pallati. Dhe mandej, po ta përsëris: derën e mbylla; apo mendoni se vetëm ju dini të mbyllni derë? Bilebile e kam mbyllur me kyç.

– Atëherë në rregull. Asgjësend tjetër nuk lypset. Me kyç, gjithsesi, mund dhe të mos e kishe kyçur. Dhe tashti, meqenëse na keni urdhëruar, uluni e rehatohuni. Jeni mysafiri im. Nuk kam as pse t'ju trembem. Mos u druani, ndjehuni si në shtëpinë tuaj. Nuk kam ndërmend as t'ju mbaj, as t'ju dëboj. Mos duhet vallë ta them edhe këtë? Çfarë, nuk po më njihni?

– Po, me të vërtetë, ju nuk duhet ta kishit thënë këtë. Përveç kësaj, këtë s'duhej ta kishit thënë. Jam ende një fëmijë; pse gjithë ajo ceremoni?

– Ua, ç'po na thoni kështu, paçi uratën. Jua pret mendja që jeni ende fëmijë. Por nuk jeni sidoqoftë dhe aq i vogël. Ju tashmë jeni adoleshent. Nëse do të kishit qenë vajzë, për ju nuk do të kishte qenë dhe aq e hijshme të hynit e të mbylleshit kaq thjesht këtu me mua në dhomë.

– Për këtë nuk ka pse e çan kokën. Desha vetëm të them: fakti që ju njoh mirë nuk është ndofarë garancie, kjo veçse ju çliron nga munda për të më gënjer. Ç'i keni këto ceremonira! Lerini, lerini, ju lutem. Përveç kësaj, unë nuk ju

njoh dhe aq mirë, jo për çdo gjë dhe jo përgjithnjë ju marr vesh, veçanërisht në këtë errësirë. Mirë do kishit bërë të ndiznit dritën. Jo, më mirë mos e ndizni. Gjithsesi, nuk do të harroj që më keni kërcënuar.

– Çfarë? Unë ju kam kërcënuar? Jo paçi uratën, unë jam kaq i gëzuar që më në fund erdhët. Thashë "më në fund", sepse tani është vonë. Nuk e kuptoj, përse erdhët kaq vonë. Ndofta ngase u gëzova dhe prej trazimit nxora e thashë turlifarë gjërash, ndërsa ju më keni keqkuptuar. Me qejf të madh e pranoj që fola turlifarë gjerash dhe madje, nëse doni, ju fyeja. Veç, për hir të zotit, s'ka pse të grindemi! Po si mund t'i zini besë kësaj që thoni?

Si ua bëri zemra të më fyeini kështu? Përse kërkoni si e si t'i përdhosni ato pak minuta që ndodheni këtu? Edhe një i huaj po të ishte në vendin tuaj, do të kishte qenë më i kujdesshëm, t'i avitej njeriut më pranë.

– Me kënaqësi e besoj; lere mos e nga, zbulim i madh! Për vetë natyrën time jam më afër jush. Këtë dhe vetë e dini, përse atëherë gjithë këto ankesa? Më mirë më thoni, ç'i keni gjithë këto spitullime, dhe unë iki sa hap e mshel sytë.

– Ja ç'na qenka! Megjithatë arrogancën s'e paskeni për gjë! Si shumë i guximshëm qenkeni. Tekembranja, në dhomën time jeni dhe si një i lojtur m'a gritë murin me thonj. Kjo është dhoma ime, është muri im! Dhe, përpos kësaj, gjithë sa po flisni, është jo vetëm e marrë, por edhe qesharake. Na thënkeni se për vetë

natyrën qenkeni i shtrënguar të kuvendoni asisoj me mua. E vërtetë është kjo? I shtrënguar prej vetë natyrës suaj? Shumë e lezetshme kjo natyra juaj. Natyra juaj – natyra ime, atëherë dhe ju, gjithashtu, jini i detyruar të silleni mirsjellshëm.

– Pse ju i sjellshëm jeni?

– Qeshë i sjellshëm.

– Nga ta dini, atëherë, ndofta edhe unë do të jem i sjellshëm.

– As ia kam idenë.

Iu avita tryezës së natës dhe ndeza një qiri që qëndronte mbi të. Asokohe në dhomën time nuk kishte as llampë vajguri, as ndriçim elektrik. Qëndrova ndenjor një grimë ndanë tavolinës, gjersa m'u shpif, mandej vasha pallton, mora nga divani kasketën dhe fika qiririn. Duke dalë jashtë u pengova pas këmbës së poltronit.

Në shkallë ndesha banorin e katit tim.

– Prapë po dilni nga shtëpia, more bjerrakohës! – tha ai, teksa ngjiti dy shkallare dhe u ndal.

– Çfarë urdhëroni të bëj, – iu gjegja unë. Tashti në dhomën time pata njëfarë fantazme.

– Ju po na flisni me një ton të pakënaquri, a thua se ju ka rënë një fije floku në supë.

– Ia keni terezinë të talleni. Por ta keni të qartë, fantazma është fantazmë!

– S'e luan topi. E çë, nëse nuk beson në fantazma?

– Po unë, sipas jush, i besoj fantazmat? E ç'del prej mosbesimit tim?

– Shumë e thjeshtë. Përpiquini ta kapërceni frikën, kur menjëmend ju sajdis fantazma.

– Po, por thelbi s'ka të bëjë me këtë frikë. Frika e njëmendët është frika para arsyes së kësaj shfaqjeje. Dhe frika mbetet. Ajo po më torturon. – Qeshë nervozuar dhe prej trazimit rrëmoja nëpër të gjitha xhepat.

– Por, nëse ju nuk i trembeni vetë fantazmës, përse nuk pyetët pra, për arsyen e shfaqjes së saj?

– Ashiqare, ju s'keni ende s'keni pasë rast me folë kurrënjëherë me një fantazmë. Mos vallë prej tyre pritët ndofarë përgjigjeje e arsyeshme! Gjithçka sillet rrotull nis e mos bitis. Një ndjesi e tillë mu sikur ato dyshojnë më fort se ne në ekzistencën e vet, çka, sidoqoftë, nuk është dhe aq e habitshme me gjithë zbehtësinë e tyre.

– E dini çfarë? Kam dëgjuar se fantazmat mund t'i ushqesh.

– Qenkeni i mirëinformuar. Mund t'i ushqesh. Po kujt ia bën zemra!

– E pse jo? Ta zëmë, fantazma është e seksit femër, – tha ai dhe ngjiti shkallaren e sipërme.


– Ah, kështu... por edhe në të tilla raste s'ia vlen, – ia ktheva unë.

U ndërmenda. Fqinji tashmë qe ngjitur lart, dhe, që të mund të më shihnte zgjaste qafën përpara.

– Por, gjithsesi, – klitha unë, – nëse provoni, kur të ngjiteni lart, ta merrni për vete fantazmën time, atëherë çdo gjë midis nesh ka marrë fund një herë e përgjithnjë.

– Unë veç shaka bëra, more, – tha ai dhe e tërhoqi qafën.

– Atëherë gjithçka në rregull, – ia ktheva. Tanimë mund të dilja pa merak në shëtitje. Por e ndjeva veten aq të vetnuar andaj dhe parapëlqeva të ngjitem lart e të shtrihem të fle.



Malisheva nis përgatitjet për sezonin e ri

MALISHEVË, 11 QERSHOR - Skuadra e Malishevës pas një sezoni historik ku përfundoi në pozitën e katërt dhe sigurojë pjesëmarrjen në ligat evropiane. Malisheva për herë të parë në histori të klubit do të marrë pjesë

në Ligën e Konferencës. Kjo skuadër ka njoftuar se të martën ka filluar përgatitjet për sezonin e ri me moton "Rikthehemi në stërvitje: Energji dhe vendosmëri e rinovuar!". "Pas një periudhe pushimi rifillojmë me stërvitje.

Kjo nuk është vetëm një rifillim i stërvitjeve, por një fillim i një kapitulli të ri të arritjeve dhe sukseseve. Në ditët dhe javët që vijnë, do të punojmë fort për të forcuar lidhjet ndërmjet nesh si skuadër, dhe për të sjellë

emocionin dhe pasionin tonë në fushën e lojës. Ekipi është në gatishmëri të plotë për të ecë para dhe të përfaqësojë me krenari ngjyrat tona. Le të bëjmë këtë, bashkë!", thuhet në njoftimin e Malishevës.



'Dardanet' U17 mbajtën grumbullim treditor

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll për vajza e ka mbajtur grumbullimin treditor seleksionues në Kampin Nacional në Hajvali, në kuadër të përgatitjes së ekipit për ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian – Liga B, që zhvillohen në vjeshtë. Në këtë grumbullim kanë qenë të përfshira 23 futbolliste, prej të cilave pesë nga vendet e përdimit, teksa ky kamp do t'i shërbejë përzgjedhës Sanije Krasniqi dhe stafit të saj për t'i seleksionuar lojtaret me të cilat do të ndërtojë ekipin për dy miqësoret kundër Bullgarisë, që do të zhvillohen më 22 e 24 gusht në Hajvali. "Tashmë e kemi bërë rutinë që në përfundim të çdo edicioni ta kemi nga një grumbullim, pasi bëhet ndërimi i

gjeneratave, por edhe shumë familje nga Diaspora vijnë në Kosovë dhe kësaj u japim hapësirë edhe vajzave nga perëndimi që të përfshihen në këto grumbullime. Ky kamp i paraprindë ndeshjeve miqësore me Bullgarinë. Ne, gjatë gjithë edicionit i përcjellim vajzat në kampionatin vendor dhe e kemi një uvertyrë për vajzat, por ky grumbullim na ndihmon që ato t'i zbatojnë detyrat në stërvitje, e sidomos anën taktike që është mungesë e madhe në vendin tonë", ka thënë Sanije Krasniqi. Kosova U17 në kualifikimet për Kampionatin Evropian është e përfshirë në Ligën B, në grup me Shqipërinë dhe Izraelin. Ndeshjet kualifikuese zhvillohen më 30 tetor e 2 nëntor.



Ademi në takim me ambasadorin Rohde vlerëson lartë mbështetjen e Gjermanisë



PRISHTINË, 11 QERSHOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, priti të martën në takim ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde. Në takim ishte i pranishëm edhe u.d. Sekretari i Përgjithshëm, Markus Weiner, që gjithashtu është nënshtetas gjerman, si dhe Taulant Hodaj, këshilltar ligjor i FFK-së. "Gjatë këtij takimi të përzemërt, presidenti Ademi shprehu mirënjohjen e tij të thellë për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania ka treguar ndaj Kosovës në fusha të ndryshme, e veçmas për futbollin. I pari i FFK-së theksoi rëndësinë e përkrahjes së mëtejme gjermane

për zhvillimin e futbollit në vendin tonë, derisa theksoi se këtë muaj Gjermania do të jetë epiqendra e futbollit, pasi do të jetë mikpritëse e Kampionatit Evropian 2024", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ambasadori Rohde shprehu falënderimet e tij për mikpritjen dhe u shpreh i impresionuar nga progresi që Kosova ka arritur në fushën e futbollit dhe sportit në përgjithësi. Në përfundim të takimit, presidenti Ademi dhe ambasadori Rohde shkëmbyen dhuratat në shenjë mirënjohjeje dhe respekti, derisa u zotuan për bashkëpunim të mëtejshëm në realizimin e projekteve të përbashkëta.

Gjimshiti: I respektojmë, por nuk duhet t'i mbivlerësojmë

Tiranë, 11 qershor - Berat Gjimshiti është kapiteni i Shqipërisë në "Euro 2024", tetë vite më vonë se në vitin 2016 kur ai nuk u ftua fare nga Gianni de Biasi. Shqipëria ndodhet në Grupin B, ku përballë ka tre Kombëtare shumë të forta si Italinë, Spanjën dhe Kroacinë. Në ndeshjen hapëse kuqezinjët

luajnë përballë Italisë, derisa Gjimshiti ka folur për këtë duel. Në një intervistë për "Gazzetta Dello Sport", kapiteni shqiptar theksoi se kuqezinjët e njohin mirë Italinë, kundërshtarin e parë që do të përballen në Evropian. Mbrojtësi që aktivizohet në Serie A me Atalantën, ka thënë se e

respektojnë Italinë, por nuk duhet që ta mbivlerësojnë. "Kur luan kundër një kombëtareje si Italia nuk është se ke shumë avantazhe në favor, por kur e njeh kundërshtarin të shërben shumë për mënyrën si përballësh në fushë. Nëse nisemi mirë kundër Italisë, atëherë do të fitojmë besim

edhe për ndeshjet e radhës, do të mund t'i menaxhoni më mirë ato", ka thënë Gjimshiti. "Italia sigurisht që është favoritja të shtunën, unë e di sepse e njoh potencialin e atyre që para tre vitesh u shpallën Kampionë të Evropës. Edhe pse pas vitit 2021, Italia ka pasur ulje dhe ngritje. Janë një kundërshtar që duhet t'i



respektojmë, por jo t'i mbivlerësojmë", ka deklaruar kapiteni i Shqipërisë.

FC Prishtina 01, kampione në Superligën e futbollit

Prishtinë, 11 qershor - FC Prishtina 01 është kampione e Kosovës në futboll për herë të dytë radhazi. Pas fitores në kryeqytet, kjo skuadër ka triumfuar edhe në ndeshjen e dytë të serisë finale kundër FC Liqenit, që u zhvillua në një atmosferë madhështore në

Drenas. Koha e rregullt e lojës u mbyll në barazim 4:4. Në vazhdimet e dy skuadrat shënuan nga një gol, duke bërë që fituesin e ndeshjes ta përcaktojnë penalltitë. Golat për FC Prishtina 01 u shënuan nga Shefki Kameri (0:1), Fitim Krasniqi (0:2), Arif Limani

(0:3), Halim Selmanaj (2:4) dhe Ramadan Alaj (5:5). Ndërkaq, për FC Liqenin shënuan Jakup Ramadani (1:3), Camillo Sanchez (2:3), Shqipron Brahimi (3:4) dhe Yulian Diaz dy herë (4:4 dhe 5:4). Në serinë e penalltive, FC Prishtina 01 tregoi

efikasitet më të mirë, duke triumfuar për të dytin vit radhazi. Trofeun për ekipin kampion e ndau presidenti Agim Ademi. Kësisoj, Prishtina 01 e mbyll edicionin me kurorën e dyfishtë, pasi paraprakisht kishte triumfuar në finale të Kupës së Kosovës.



Edhe në këtë garë në finale e kishte mposhtur FC Liqenin.

De Biasi paralajmëron Italinë: Shqipëria nuk duhet nënvlerësuar

Në faqet e "Gazzetta dello Sport" nuk mund të mungonte opinioni i Gianni De Biasit, italianit që çoi Shqipërinë për herë të parë në Evropian, në "Francë 2016".

Ish-trajneri i kuqezinjve u është përgjigjur tri pyetjeve për Kombëtaren shqiptare, ku thekson se ajo nuk duhet nënvlerësuar aspak, por sheh Italinë si favorite. De Biasi ka pohuar gjithashtu se loja e Shqipërisë kundër Italisë do të varet nga strategjia e trajnerit Silvinjo, ndërkohë që ka evidentuar tifozët si një faktor të rëndësishëm për ndeshjen e së shtunës në Dortmund.

De Biasi, si ish-trajner i Shqipërisë, a e ndoqet atë në miqësoren kundër Azerbajxhanit, tjetër ekip që ju e keni drejtuar së fundi?

De Biasi: Po, Shqipëria fitoi 3-1, por ishte një ndeshje e luftuar. Mund të them se Shqipëria më pëlqeu për mënyrën si dilte nga prapa me top.

Italia, çfarë duhet të ketë kujdes nga Shqipëria për ndeshjen e së shtunës në Gjermani?

De Biasi: Në mesfushë, Asllani dhe



Ramadani dinë të filtrojnë dhe të rinisin aksionin. Sulmuesi kryesor, Broja, është i fortë fizikisht dhe mund të shfrytëzojë çdo rast minimal. Asani dhe Seferi i japin fantazi skuadrës shqiptare nga krahët. Dhe kujdes nga tifozët e tyre: të shtunën në Dortmund do të jenë me mijëra shqiptarë entuziastë.

Cilat janë pikat e dobëta të kësaj

skuadre?

De Biasi: Nuk e di çfarë taktike do të zgjedhë trajneri Silvinjo, nëse do ta sulmojë Italinë, apo do ta presë. Shqipëria e tij bën një lojë propozitive. Silvinjo ka pasur maestro të mëdhenj në karrierë, për shembull, ka punuar me Roberto Mancinini. Shqipëria është një kundërshtar që nuk duhet nënvlerësuar dhe këtë Spalletti e di mirë. Italia është favorite.

'Eurosport': Mos nënvlerësoni Shqipërinë, kujdes nga Broja

Londër, 11 qershor - Media prestigjioze ndërkombëtare "Eurosport", i ka dhënë një hapësirë të veçantë në analizën që i bën skuadrave pjesëmarrëse në "Euro 2024", edhe kombëtares kuq e zi. "Një ekip ambicioz, këmbëngulës dhe i përgatitur. Kundërshtari i parë i 'Axurrëve' në 'Euro 2024' është më i vështirë sesa mund të pritët. Kombëtarja e Sylvinhos, në fakt, u kualifikua shumë përpara për kompeticionin e Gjermanisë dhe në ndeshjen në 'Westfalenstadion' të Dortmundit ka të gjithë potencialin për të vënë në vështirësi Italinë e Spallettit. Blloku 'italian' i përbërë nga Gjimeshiti, Ismajli, Asllani, Bajrami, Ramadani, Berisha dhe Kumbulla kryeson një grup të larmishëm dhe cilësor. Shqipëria është një ekip që nuk i trembet



askujt, mund të krijojë probleme të ndryshme për Italinë, Kroacinë dhe Spanjën. Sylvinho praktikon futboll të ekuilibruar në të cilin kujdeset shumë për fazën e mbrojtjes, pa mohuar megjithatë agresionin e menjëhershëm pasi humbet

posedimin e topit. Duhet kujdes i veçantë për Armando Broja, i cili pas një mungese gati dyvjeçare për shkak të dëmtimit, po i afrohet kampionatit evropian me një formë të shkëlqyer dhe një besim të ri", shkruan ndër të tjera "Eurosport".

SHKURT

Llapi konfirmon largimin e Limanit

Skuadra e Llapit ka njoftuar se ka ndërprerë bashkëpunimin me futbollistin Gentrit Limani. Dëshira e futbollistit ishte që klubi ta mirëkuptoj për të ndërruar ambient dhe ne e kemi mirëkuptuar dëshirën e tij. Limani u transferua te Llapi në janar të vitit 2023 dhe gjatë një sezoni e gjysmë u paraqit në 39 ndeshje zyrtare, ku kontribuoi edhe me katër asistime. "Geni" ishte ndër futbollistët më korrekt të ekipit me sjellje shembullore për çka e vlerësojmë lartë personalitetin e tij. Klubi ynë e falënderon për kontributin e dhënë për klubin si dhe i dëshiron shumë suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Llapit.

Pas De Jongut, Holanda mbetet edhe pa Koopmeinersin

Nuk kanë fund telashet për Holandën e Ronald Koeman. Vetëm disa orë pasi Holanda humbi një prej mesfushorëve më të talentuar, Frenkie De Jong, tani duhet të bëjë edhe pa mesfushorin e Atalantës, Teun Koopmeiners. Futbollisti i "tulipanëve" u lëndua tekso po kryente nxehtjen, përpara miqësore që Holanda zhvilloi të hënën në mbrëmje përballë Islandës, në Rotherdam. Në këtë mënyrë tekniku Koeman, duhet të "privohet" nga tre mesfushorë shumë të rëndësishëm, të skuadrës siç janë Frenkie De Jong, Teun Koopmeiners si dhe Marten de Roon.

Klose emërohet trajner i Nurnbergut

Skuadra gjermane Nurnberg e ka emëruar trajner ish-futbollistin legjendar të Gjermanisë, Miroslav Klose. 46-vjeçari zejen e trajnerit e filloi në vitin 2016-të pasi u pensionua nga futbollit aktiv. Ai fillimisht u caktua si ndihmëstrajner tek kombëtarja gjermane. Nga 2018-ta i drejtoi kategoritë e reja të Fc Bayernit (U-17 dhe U-18). Ndërkaq, më pas punoi si ndihmëstrajner te skuadra e parë "bavareze", ku luajti edhe vet për disa vite duke dhënë kontribut të çmuar. Klose si futbollist ka djersitur fanellën edhe të ekipeve si Werder Bremen dhe Lazio.

Milani e dëshiron Rabiotin, pengesë është paga e lartë e francezit

Është ende e pazgjidhur e ardhmja e futbollistit Adrien Rabiot. Mesfushorin francez i përfundon kontrata me Juventusin këtë muaj dhe ende palët nuk janë dakorduar për një të re. Këtë situatë delikate po synon ta shfrytëzojë Milani, të cilët e dëshirojnë në ekip francezin. Sipas raportimeve të medieve italiane, Milani ka kontaktuar me Rabiotin për ta bindur për të këtë transferim, megjithatë kjo lëvizje shihet pak e vështirë, pasi paga e francezit te Juventus është shumë e lartë. Në 31 paraqitjet e këtij edicioni në Serie A, Rabiot ka shënuar pesë gola dhe ka dhuruar tri asistime.

Chelsea synon rikthimin e Kane në Premierligë

Sulmuesi Harry Kane nuk fitojë asnjë titull me Bayern Munchen dhe ai mund të rikthehet sërish në Premier Ligë. Në fakt, Chelsea

është e interesuar për sulmuesin anglez. Sipas raportimeve të mediave britanike, bordi i "Londinezëve" po monitoron

situatën e qendërsulmuesit anglez te "bavarezët" me shpresën për të transferuar në verë. Kane nuk është i lumtur

pavarësisht 37 golave dhe 12 asistimeve të realizuara në 35 paraqitje sezonale, prandaj ideja e Chelsea është të hyjë në një

negociatë të mundshme me "Uraganin", që konsiderohet si numri 9 ideal për të zgjidhur problemet ofensive.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT




SWISS

TAVERNA




Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





Lume's Details


Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Palma" Sh.p.k Gjilan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të mobileve në Shillovë, Gjilan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.07.2024 në ora 11:00 në hapësirat e shkollës SHFMU "Abdullah Tahiri" në fshatin Malishevë komuna e Gjilanit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Palma" Sh.p.k Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Palma" Sh.p.k Gjilan, për fabrikën e prodhimit të mobileve në Shillovë, Gjilan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Entela Krasniqi shpall të pavlefshme Diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Miran Xhelili, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës, me nr. KO-46627/A-05-20 Diploma: 0148/9 datë, 24.06.2013 Gjilan.

- Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Florije Rama Molliq KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Bajram Sadriu" Berjah nga kl. 1-8.

- Qëndresa Gjokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Tahir Asllani Brovin KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Mimoza Paloja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat kl. 10.11.12.13. të sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 39 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 785 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit rishpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita: Përkthyes – nga gjuha shqipe në gjuhë serbe anasjelltas;
Numri i referencës: RPSA/ZKA/06-09/24
Grada: ZKA-C6
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon Udhëheqësin e divizionit në përcaktimin e objektivave dhe hartimin e planeve të punës;
- Bën përkthimin e dokumenteve nga gjuha shqipe në gjuhë serbe dhe anasjelltas sipas normativit të përcaktuar për një ditë pune. Normativi mesatar për përkthim të dokumenteve brenda një ditë pune përfshinë mesatarisht 2000 fjalë.
- Bën përkthimin simultan në takime pune, punëtori, konferenca, trajnime dhe në raste të tjera sipas nevojave të ZKA-së;
- Ndihmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim të qartë dhe sipas normave gramatikore dhe të sintaksës;
- Mban bazën e të dhënave dhe informacioneve lidhur me përkthimet e bëra të të gjitha dokumenteve.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale prej tyre një (1) vit dëshmi në fushën e përkthimit.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve;
- Njohuri në terminologjinë e fushës së auditimit, kontabilitetit dhe financave;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **27.06.2024 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije, vezano sa članom 39 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2024. godinu, kao i Odluke Generalne Revizorke Br. 785 za popunjavanje slobodnog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije ponovo objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Položaj: Prevodilac - sa albanskog na srpski i obrnuto;
Broj reference: RPSA/ZKA/06-09/24
Nivo: ZKA-C6
Broj radnih mesta: Jedno (1)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže vodi odeljenja u postavljanju ciljeva i izradi planova rada;
- Vrši prevod dokumenata sa albanskog na srpski i obrnuto prema normi utvrđenoj za radni dan. Prosečna norma za prevođenje dokumenata u toku radnog dana obuhvata u proseku 2000 reči.
- Vrši simultano prevođenje na radnim sastancima, radionicama, konferencijama, obukama i u drugim slučajevima prema potrebama NKR-a;
- Pomaže u definisanju i usaglašavanju terminologije, za prevedene dokumente i dokumente, kao i njihovu tačnost sa jasnim značenjem i u skladu sa normama gramatike i sintakse;
- Održava bazu podataka i informacije u vezi sa prevodom svih dokumenata.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva od kojih jedna (1) godina dokaz u oblasti prevođenja.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti prevoda;
- Poznavanje terminologije revizije, računovodstva i finansija;
- Veština u komunikaciji i planiranju rada;
- Sposobnost izvršavanja zadataka i poslova pod pritiskom;
- Računarske veštine programskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovana;
- dokazi o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnom odlukom (ne starija od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (*ako je primenljiva*);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*online*) i na sajtu Nacionalne Kancelarije Revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **27.06.2024 do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992





ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L